



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit


Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPĆINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë ja përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 6647 Më 29.12.2023
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC



RAPORTI VJETOR I PUNËS 2023

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

TABELA E PERMBAJTJES

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport _____

Letërnjofrimi i shkurtër për Kulturën, Rinin, Sportin në Rahoyec _____

Aktivitetet e Muajit Janar- Qershori _____

Biblioteka Komunale “Sulejman Krasniqi” _____

Palestra Sportive “Mizahir Isma” _____

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Letërnjoftimi i shkurtër lidhur me Kulturën, Rinin dhe Sportin në Rahovec.

Komuna e Rahovcit shtrihet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Kosovës. Është ndër qytetet më të vjetra të Kosovës, me relikte antike të trashëguara nga epokat e hershme ilire-romake, objekte të trashëgimisë arkitekturore, shpirtërore, fetare, etnologjike etj. Turizmi kulturor kryesisht mund të jetë i bazuar në trashëgimi kulturore/ arkitekturore: shtëpitë tradicionale, turizëm arkeologjik, shpella, trashëgimi arkitekturore dhe fetare. Në komunën e Rahovcit zhvillohen aktivitete të ndryshme kulturore, rinore e sportive, aktivitete muzikore, teatrale, bibliotekare, ekspozita, festivale e aktivitete të ndryshme kulturore. Aktivitete të ndryshme zhvillohen në qendrat kulturore në Rahovec, Krushë të Madhe, Lloçë të Madhe, Ratkoc, Xerxë, Drenoc e gjetkë. Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi", me degët në Krushë të Madhe, Ratkoc e Hoçë të Madhe me mbi 27.814 ekzemplarë, si qendrat sportive në Rahovec, palestra "Mizahir Isma", terrenet e sportit në Krushë të Madhe, Xerxë, Ratkoc, Dejnë dhe në disa lagje të qytetit, ofrojnë mundësi të mira për zhvillimin e sportit e rekreacionit. Po ashtu, funksionojnë shoqëritë kulturore-artistike, grupet muzikore e artistike, shoqatat e ndryshme, një qendër rinore aktive, që zhvillojnë aktivitete në këto objekte kulturore, rinore e sportive. Ndërkohë aktivitetet kryesore kulturore e promovuese që organizohen në komunën e Rahovcit janë; festivali i folklorit "Anadrinia Jchon" festa e Vjeljes së rrushit "Hardh Fest", "Agrofesta", Festivali Ndërkombëtar i Poezisë, si dhe aktivitete të ndryshme periodike kulturore, rinore, sportive e promovuese.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e përbërë prej tre sektorëve: Kulturë, Rini dhe Sport, me një buxhet të caktuar, i mbulon tre fusha të rëndësishme në jetën e përditshme.

Aktivitetet që i përfshin drejtoria janë: aktivitetet rinore, sportive, ruajtja e trashëgimisë kulturore, shfaqjet teatrale, muzikë, art.

- Në raport të punës janë të përfshira shumica e aktiviteteve të zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitete e projekte, në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore e historike, bibliotekarisë, sportit dhe rinisë.
- Personeli i DKRS-së përgjatë kësaj periudhe, është angazhuar që të gjitha projekte e aktivitete të parapara të përfundohen me sukses, duke bërë përpjekje edhe për sigurim të mbështetjes financiare shtesë, përfshirë mbështetje nga niveli qendror; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.
- Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm, ka qenë konstruktiv dhe ka rezultuar me sukses në disa prej aktiviteteve të realizuara përgjatë kësaj periudhe.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport poashtu trajton kërkesat e palëve për shfrytëzimin e këtyre objekteve kulturore e sportive:

- Shtëpia e Kulturës në: Rahovec, Ratkoc, Xërxe, Krushë të Madhe dhe Drenoc.
- Bibliotekën “Sulejman Krasniqi” në Rahovec, Krushë të Madhe dhe Hoçë të Madhe.
- Stadiumin “Jahja Danuza” në Rahovec dhe fushat tjera sportive.
- Palestrën “Mizahir Isma”.

Përveq buxhetit të caktuar komunal, drejtoria ka bërë përpjekje për të gjetur edhe burime të tjera financiare përmes bashkëpunimit me OJQ, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në vendin tonë, strukturat e pushtetit lokal, donatorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe pushtetin qendror MKRS-në.

Çfarë kemi arritur?

Shënimet e mëposhtme përmblledhin aktivitetet kryesore dhe të arriturat e DKRS-së nga janari deri në qershor të vitit 2023. Informata më të hollësishme janë dhënë në aneksin e këtij raporti, që ofron informacion të hollësishëm të veprimtarisë së DKRS-së.

AKTIVITETET: JANAR-DHJETOR

- Akativiteti perkujtimor-kultuor “Flaka e Janarit-2023”
- Takimi me kshillin organizues në shënimin e 17 Shkurtit “Dita e shpalljës së Kosovës Shtet i Pavarur”.
- Takimi i komisionit për vlerzimin e punimeve në artin figurative në përzgjedjen e punimeve më të vlersuara, punime këto në konkurrencë me rastin e 17 shkurtit Ditës së pavarsisë së Kosovës.
- Vendosja e eskpozitës në galerinë e arteve në qendrën e kulturës “Mensur Zyberaj”.
- 17 Shkurt, aktivitete kulturore kushtuar 17 Shkurtit “Ditës së Pavarsisë”.
- Vizit pune në shkollën fillore “Faik Konica”, celinë, qëllimi i takimit njësotimi i drejtorisë së shkollës me qëllim të informimit të nxënësave rreth trashigimisë kulturore të komunës sonë.
- Është plotsuar formulari për subvencione në kulturë, rini dhe sport, kërkuar nga ministria e financave e qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Vizit monumenteve të trashigimisë kulturore të komunës sonë me një pjesë të stafit të drejtorisë.
- Në sallën e qendrës së kulturës “Mensur Zyberaj” është shënuar Dita e Mësuesit “7 Marti” me aktivitet kultuor.
- Është shënuar me një aktivitet kulturor Dita ndërkombëtare e poezisë me grupin letrar të qendrës rimore SHL-Kosova.
- Ekspozitë me fotografi në parkun e qytetit “Rahoveci ndër vite”.
- Drejtoria ka përcjellur me zërim qdo tubim përkujtimor që është mbajtur në komunën tonë.
- Po ashtu gjatë vitit në bashkëpunim me disa prej shkollave të komunës sonë dhe ato: Shkolla profesionale “ selajdin Mullabazi-Mici”, shkolla fillore “Hamëz Thaqi”, sh.f “Sadedin Hajda”, sh.f “Bekim Sylka”, kemi realizuar disa vizita në monumentet e kulturës dhe muzet e komunës sonë, qëllimi i vizitave ishtë njojja për së afërmë e të rinjëve tanë më pasurin kulturore dhe shpirtërore që ka komuna jonë.
- Është realizuar aktivitet me rastin e “Ditës ndërkombëtare të monumenteve”.
- Në bashkëpunim me klubin letrar “Xhevdet Bajra”kemi shënuar “Ditësn ndërkombëtare të librit”.
- Shënim i aktiviteteve kulturore-përkujtimore “java e Dëshmorëve të Kombit”
- Në qendrën kulturore “Mensur Zyberaj” është mbajtur festivali i muzikës Do-Re-Mi.
- Shënim i aktivitete kulturore i ditës së qendrës së kulturës “Mensur Zyberaj”.
- Koncert në qendrën e kulturës “Mensur Zyberaj”, “Kokërr rrushat këndojn”.


- Shënimi i Ditës botore të fëmijëve, aktiviteti është realizuar në bashkëpunim me shoqatën e gruas “Harcja”, vendi i mbajtjes qendra e kulturës “Mensur Zyberaj”.
- Shfaqje teatralc për fëmijë me rastin e ditës botore të fëmijëve, në bashkëpunim me teatrin e kukullave Prishtin, vendi i mbajtjes, qendra e kulturës “Mensur Zyberaj”, Rahovec.
- Aktivitet, Mrasor në shtëpin Muze “Skender Regjepi”, me rastin e shënimit të datëlinjës së heroi.
- Aktivitet, përejellja me zërim, shënimi i ditës së shkollës “Hamëz Thaqi”, Xërxe.
- Vizit në shtëpin e kulturës në fshatin Xërxe dhe shtëpin e kulturës “Feim Gashi” në Drenoc
- Aktivitet kompleksi memorial në Gradish, ndarja e mirënjojëve mër veteranët e UÇK-së post-mortem, pregadijtja teknike për mbarëvajtjen e aktivitetit.
- Aktivitet, koncert festiv me rastin e shënimit të ditës së Çlirimit të komunës së Rahovcit.
- Aktivitet kulturor dhe përvimi I objektit të ri muzeu “Ukshin Hoti”, Krushë e Madhe.
- Gjatë vitit kemi realizuar disa takime me zyrtarë të qendrës rajobale për trashegimi kulturore në Prizren, qëllimi i takimit bashkëpunimi dhe futja e disa prej monumenteve të trashegimisë kulturore të komunës sonë në listën e MKRS-së për mbrojtje të përkohshme, ku pas përpjekjeve tona janë futur dhe 6 (gjashtë) asete të rëndësishme të trashegimisë komunës sonë.
- Në qendrën e kulturës “Mensur Zyberaj” është mbajtur program kulturor me nxënës të shkollës së mesme “Xhelal Hajda-Toni”.
- Po ashtu gjatë fundit të muajit nëntor, shkolla e muzikës në bashkëpunim me drejtoren e kulturës, në qendrën e kulturës “Mensur Zyberaj” ka mbajtur festivalin për gjatë dy netëve “N’ Rahovec e kem konakun”.
- Kemi realizuar disa nga aktivitetet kulturore dhe sportive të parapara me rastin e festive të Nëntorit.

Investimet Kapitale:

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport jemi duke punuar në ndërtimin e tereneve sportive ku me datë 27.04.2023 është bërë përvimi I fushës sportive në fshatin Gexhe.



- Punimet në ndërtimin e fushës sportive në Malësi të Vogël kanë filluar me datë 03.05.2023 dhe janë duke vazhduar punimet, do të vazhdojm rregullimin e fushave sportive në të gjitha vendbanimet e komunë sonë.
- Ndertimi i Kompleksit Muzeor “Ukshin Hoti” në Krushë të madhe, përrurimi i kompleksit është bërë me 17 Qershor 2023.



- Ndertimi i Aneksit të shtëpia e Kukturës në Krushë të Madhe, punimet janë duke vazhduar dhe jemi në fazën e dytë të punimve ku do të bëhet suvatimi dhc rregullimi I hapsirë së mbrendshme të objektit.
- Ndertimi i Kompleksit Sportiv, punimet janë duke vazhduar në rregullimin e ketij kompleksi ku do të ketë një fushë të futbollit të madh, dy fusha të basketbolli, dhe shtegun e Atletikës.

- Në kuadër të projektit “Ndërtimi i parqeve dhe këndëve rekreative përfshimjë” është bërë rregullimi i Parkut te stacioni i autobusave, përvimi i parkut Brenda muajit Qershor.
 - ❖ DKRS-ja do të vazhdoj me rregullimin e parqeve dhe këndet e lojrave përfshimjë edhe në vendbanimet tjera. Shtimi i hapësirave të gjelbëruara është një nga priorititetet e Komunës së Rahovecit, duke mundësuar kështu që qytetarët të pushojnë dhe kalojnë kohë më shumë në mjedis të hapur.

BIBLIOTEKA KOMUNALE “SULEJMAN KRASNIQI”-RAHOVEC

Biblioteka Komunale “Sulejman Krasniqi”- Rahovec
Me degët e saja në Krushë të Madhe dhe Ratkoc

Sektori i huazimit të librit:

Janë regjistruar: Anëtar 874.

Me pagesë 861, Falas 13.

Sh.Fillore 749, Sh.Mesme 64, Student-e 20, Punëtor-e 19, Bujq 0, Amvise 1, Të tjera 21.

Meshkuj 367, Femra 507.

Libra të lexuara: 7939. Meshkuj 3075, Femra 4864.

Sallën e leximit: e kanë shfrytëzuar 841 lexues-e.

Sektori i përpunimit të librit

Pasurimi i fondit librar: 1833 ekzemplar.

Fondi total i librave në biblioteka: 27915 ekzemplar.

Aktivitete: Janar

Me datë: 05.01.2023 Dhuratë nga Autore Fara Pallqa me 1 tituj, 10 ekzemplar.

Mc datë: 05.01.2023 Dhuratë nga Autori Hazir Luta me 1 tituj, 5 ekzemplar.

Aktivitete: Shkurt

Mc datë: 23.02.2023 Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, u zhvillua ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit mes Ministrisë së Kulturës dhe 31 Bibliotekave Komunale.

Përmes tyre ofrohet mbështetje financiare në vlerë prej 6,451 euro për furnizim me fond librar të çdo bibliotike.

Aktivitete: Mars

Me datë: 13.03.2023 Në shënim të ditëlindjes së Profesorit Sabahajdin Cena, përruam Këndin e librit shkencor në bibliotekën komunale "Sulejman Krasniqi". Në rastet e këtij këndi janë sistemuar një mori veprash, shumë botime të profesorit, si dhe vëllime të shumta me përbajtje shkencore. Besojmë se lexuesit do të vijojnë të frekuentojnë sa më shpesh në këtë bibliotekë dhe të shfetojnë materialet e vyshtme që janë aty. Ne do të vazhdojmë ta pasurojmë bibliotekën me tituj të rinj dhe të ofrojmë sa më shumë mundësi për nxënësit tanë dhe të pasionuarit pas librit.

Po ashtu biblioteka është pasuruar me 63 tituj të ndryshëm të librave të dhuruara nga familja e profesorit të ndjerë Dr. Sabahajdin Cena, dhe me 21 tituj të ndryshëm të autorit Besim Muhadri.

Me datë: 16.03.2023 Në kuadër të projektit Ndihmë në detyra të shtëpisë, aktiviteti takime me shkrimitar, sot fëmijët takuan shkrimitarin dhe publicistin Qemajl Krasniqi ku biseduan për rëndësinë e leximit të librave. Fëmijët poashtu patën mundësinë ta vizitojnë bibliotekën komunale "Sulejman Krasniqi".

Me datë: 17.03.2023 Nxënësit e shkollës „Isa Boletini” të shoqëruar nga mësimdhënës Adelina Shabandula vizituan bibliotekën komunale "Sulejman Krasniqi", u njohen me librat dhe aktivitetet që mund ti realizojnë në bibliotekë. Për krijimin e shpreshis së leximit rol shumë të rëndësishëm kanë mësimdhënësit, që në mënyrë të rregullt i orientojnë nxënësit për lexim.

Me datë: 21.03.2023 SHL Kosova Në bashëpunim me DKRS shënuan Ditën Ndërkombëtare të Poezisë me orë letrare.

Me datë: 30.03.2023 Autori Rexhep Krasniqi ekspert i vreshtarës dhe verarisë pasuroi bibliotekën me 36 ekzemplarë, libra që do të jenë të dobishëm për nxënësit, studentët, vreshtarët, vërtarët dhe lexuesit në përgjithësi.

Aktivitete: Prill

Me datë: 24.04.2023 Në mjediset e bibliotekës komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec u shënua Dita Botërore e Librit. Në këtë debat kushtuar librit u fol për rëndësinë e të lexuarit, gjendjen e bibliotekave në komunën e Rahovcit dhe nevojën e furnizimit të rregullt me literaturë të nevojshme e të kërkuar nga lexuesit. Para një numri të madh të fëmijëve nga shoqata Hareja dhe poetëve të Komunës së Rahovcit Afrim Dina drejtor i DKRS, prezantoi punën dhc angazhimet që janë bërë e po bëhen përritjen e nivclit të lexueshmërisë.

Për ta nderuar këtë aktivitet i pranishëm ishte edhe nën kryetari i Komunës z. Fatmir Iska, ku me një fjal rasti i përshtendetit të pranishmit dhe i inkurajoj fëmijët që sa më shumë të vizitojnë bibliotekën dhe të lexojnë sa më shumë libra.

Autori Xheladin Hamza pasuroi bibliotekën me pesë (5) ekzemplarë tituj të ri.

Ky aktivitet është organizuar nga DKRS, Shoqata Hareja dhe Klubi Letrar Xhevdet Bajraj.

Me datë 26.04.204 Bajram Kryeziu pasuroi bibliotekën tonë me dy (2) ekzemplarë

Aktivitete: Maj

Me datë 02.05.2023 Dorëzimi i librave në degat tona Krushe e Madhe 12 ekz. dhc Ratkoc 12 ekz.

Më datë 28.03.2023 Biblioteka jonë është pasurur me 1622 ekzemplar nga MKRS në projektin me vlerë 6541 euro, ku gjatë muajit prill-maj 642 ekzemplar janë inventarizu në bibliotekën amë, kurse 200 ekzemplar janë dorëzu në degën e Krushës së Madhe, dhe 780 ekzemplar në degën e Ratkocit.

Me datë 10.05.2023 Kemi marrë pjesë në takim konsultativ në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës me qëllim të bashkërendimit të aktivitetve për veprimitarinë Java e Bibliotekës në Kosovë edicioni i 20-të 22-28 maj 2023.

Me datë 24.05.2023 Kemi marrë pjesë në kuadër të Java e Bibliotekës në Kosovë 2023, në Bibliotekën Publike "Ibrahim Rugova" në Gjakovë, ku është mbajtur sesion informues "Biblioteka publike dhe transformimi i shërbimeve".

Gjatë këtij sesioni, pjesëmarrësit patën mundësi të informohen për së afërmë për temat si:

- Engjëll Berisha: - Biblioteka publike dhe transformimi i shërbimeve.
- Teuta Kryeziu: - Burimet elektronike dhe përdorimi i tyre në bibliotekë.
- Nasibe Shtaloja: - Veprimitaria botuese dhe bibliotekat dhe
- Arborec Pozhegu: - Shërbimet këshilldhënëse për lexues.

Me datë 24.05.2023 Kemi marrë pjesë në kuadër të Java e Bibliotekës në Kosovë 2023 në Prizren ku u organizuan sesione me pjesmarrje të punëtorëve të bibliotekave të Kosovës, prof. Amerikan, nga Tirana, Korça, Tetova etj. :

- Sesioni „Shërbimet e referencave në bibliotekë nga forma tradicionale në atë moderne“ ku me kumtesa u paraqiten Sahadete Sadikaj – Kukaj, Lavdije Rrahmani, Shqipe Asllani, Alban Murtezaj .
- Sesioni , “Bazat e shkrimit dhe botimit të një monografie” ku me kumtesa u paraqiten: Orhan Bislimi, Skender Susuri, Ibrahim Sknderi, Xhafer Beqiraj, Rrahman Rexhaj si dhe bashkëbisedues autor dhe krijues të tjerë.
- Ndërsa aktiviteti i planifikuar me Autostraden Biennale “Rëndësia e hapsirave të përbashkëta për lexim” mbeti të realizohet gjatë kësaj javë.

Aktivitete: Qershori

Me datë: 01.06.2023 1 Qershori - Dita e fëmijëve. Nën përcjelljen e mësimdhënësve nxënësit e shkollave fillore e vizituau bibliotekën komunale "Sulejman Krasniqi".

Me këtë rast, u pritën nga punonjësit e bibliotekës, ku i njoftuan nxënësit me fondin librar përfëmijë që ka biblioteka, proçesin e marrjes së librave në huazim, kohëzgjatjen e mbajtjes së tyre.

Në fund të vizitës, intercimi për regjistrim ishte i madh, që të bëhen anëtarë të rinj të bibliotekës duke marr me vete librat e tyre të preferuar për lexim.

Me datë: 14.06.2023 Për ndër të 14 Qershoret - Ditës së Çlirimtës së Rahovecit, në hapësirat e Bibliotekës Komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, u mbajt manifestimi "Ora Poetike", në të cilën morën pjesë nxënës të Shkollave të Mesme të Larta dhe të Shkollave Fillore të Mesme të Ulëta.

Nxënësit pjesëmarrës interpretuan proza e poezi nga autorë të ndryshëm.

Me datë 17.06.2023 Autori Hamit Gurguri e pasuroi bibliotekën tonë me katër (4) ekzemplar të ri.

Aktivitete: Korrik

Me datë 04.07.2023 Vizit e nxënësve të klasëve të katërtë të shkollës „ Isa Boletini” në bibliotekë, ku u njohën me librat e reja si dhe me aktivitetet e shumta që mund ti realizojmë së bashku . Kënaqësi kur nxënësit janë kurresttar dhe bëjnë pyetje të ndryshme për bibliotekën dhe librat.

Aktivitete: Gusht

Me datë: 09.08.2023 Autori Shpend Gjoci e pasuroi bibliotekën Komunale “Sulejman Krasniqi” me 9 ekzemplar të ri.

Me datë: 11.08.2023 Në sallën e bibliotekës u mbajtë ligjerata për mcnaxhimin, informimin dhe edukimin e grave dhe vajzave rrëth parandalimit të sëmundjeve masovik jo-njitetëse.

Kjo ligjeratë u organizua në kuadër të projektit “Promovimi i kujdesit shëndctësor primar për gratë në vendet rurale”. Ky projekt u zbatua nga Shoqata “Gruaja Fermere” dhe u mbështet nga Fondi i grave të Kosovës.

Aktivitete: Shtator

Me datë: 29.09.2023 Autori Esat Ruka pasuroi bibliotekën komunale “Sulejman Krasniqi” me gjashtë ekzemplar (6), falenderojmë autorin për ndihmën e dhënë në përhapjen e vlerave të dijës.

Aktivitete: Totor

Me datë : 06.10.2023 Fillimi i projektit të gjuhës angleze me punëtorët e bibliotekave të - Prizrenit, Suharekës, Malishevës, Dragashit, Rahovecit si dhe bibliotekave shkollore. Ky projekt mbështetet nga Ambasada Amerikane me qëllim të shtimit të efikasitetit të punës në bibliotekë.

Me datë: 12.10.2023 Biblioteka Komunale “Sulejman Krasniqi” ćshtë pasuruar me disa libra të rinj. Instituti i Historisë “Ali Hadri” dhuroi bibliotekës tonë 61 ekzemplarë librash ose 47 tituj të ndryshëm, si dhe 14 revista. Librat janë kryesisht studime historike, monografi dhe revista të ndryshme. Dorëzimin e donacionit e ka bërë drejtorecsha e Institutit Prof.asoc.dr.Teuta Shala-Peli. Tashmë librat janë në rastet e bibliotekës tonë në pritje të lexuesve dhe hulumtuesve të ndryshëm. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport falënderon drejtorecshën dhe stafin drejtues të Institutit të Historisë për këtë dhuratë të vlefshme.

Me datë: 27.10.2023 Biblioteka Komunale Sulejman Krasniqi u pasurua me tre (3) ekzemplar të ri. Autori i librit Gazctari gjerman Erich Rathfelder "Kosova- Historia e një konflikti " Botimi Artini - Prishtinë.

Aktivitete: Nëntor

Me datë: 24.11.2023 Për ndër të festës së 28 Nënëtorit – Ditës së Flamurit, në Bibliotekën “Sulejman Krasniqi”-Rahovec, u mbajt një ore letrare me nxënësit e shkollave të Komunës së Rahovecit.

Në këtë takim me nga një fjalë rasti i përshëndetën të pranishimit drejtori i DKRS-së Afrim Dina dhe drejtori i DKA-së Avni Morina.

Këtë organizim e përgaditen Profesor Sokol Gashi dhe Profesor Milazim Bajraj së bashku me nxënës.

Me datë: 24.11.2023 Kemi marrë pjesë në ceremonin festive Dita e Bibliotekës Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani” e cila shënoi 79-Vjetorin e themelimit.

Anëtarësia dhc libra të lexuara

Janar - Dhjetor	Anëtar	Meshkuj	Femra	Me pagesë	Falas	Lib. të lex.	Meshkuj	Femra
Rahovec	733	315	418	721	12	6464	2581	3883
Krushe	63	21	42	63	0	954	314	640
Ratkoç	78	31	47	77	1	521	180	341
Gjithsej	874	367	507	861	13	7939	3075	4864

Perbërja sociale e lexuesve

Janar - Dhjetor	Sh.Fillore	Sh.Mesme	Student-e	Punëtor-c	Bujq	Amvise	Të tjerë	Gjithsej
Rahovec	632	54	18	19	0	1	9	733
Krushe	47	8	2	0	0	0	6	63
Ratkoç	70	2	0	0	0	0	6	78
Gjithsej	749	64	20	19	0	1	21	874

Salla e leximit - Pasurimi i fondit librar - Fondi librar në biblioteka

Janar - Dhjetor	Salla e leximit	Pasurimi i fondit librar	Fondi librar në biblioteka
Rahovec	173	829	21527
Krushe	68	212	4551
Ratkoç	600	792	1837
Gjithsej	841	1833	27915


PALESTRA SPORTIVE “MIZAHIR ISMA”

Gjatë kësaj periudhe Janar-Qershori në palestrën sportive “Mizahir Isma” janë realizuar aktivitetet të shumta sportive, si nga klublet të Komunës së Rahovecit, ashtu edhe nga ata ndërkombëtar.

Klubet sportive si: Basketbolli, Hendbolli, Futsalli kanë zhvilluar aktivitete të shumta në Palestrën sportive “Mizahir Isma”, vlenë të ceket se me datë 16.02.2023 është mbajtur kupa e Kosovës në Basketball “Final 8”.

AKTIVITETE GJATË MUAJIT KORRIK DHE GUSHT

Gjatë kësaj periudhe DKRS ka realizuar aktivitetet të shumta sportive e kulturore në kuader të aktiviteteve të “MUAJIT TË MËRGIMTARËVE” si dhe është bërë përvimi i projekti të parkut të stacioni i autobusave në Rahovec.



- Janë organizuar aktivitete për “Muajin e mërgimtarëve”, nga data 15 korrik dhe janë përmbyllur më 15 gusht, kanë qemë të organizuar mirë dhe janë pritur jashtzakonisht mire nga qytetarët tanë.

Me qëllim të ofrimit të mundësisë për takime reciproke ndërmjet mërgimtarëve tanë dhe takimeve me autoritetet lokale, Komuna e Rahovecit, konkretisht DKRS-ja ka organizuar turne në futboll, shah, koncerte dhe ndeja me mërgimtarët (sofra e mërgimtarit) në disa lokalitete, në Drenoc, Çifllak dhe Opterushë.



- Në kompleksin e dëshmorëve në gradish është organizuar koncert shumë cilësor me këngëtarë të njohur dhe me artistë të rinj po ashtu kishte pjesmarres edhe artist nga mërgata .

MIRË SE VINI MËRGIMTARË!



MIRË SE VINI MËRGIMTARË!




- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte e Komunës së Rahovecit në bashkë organizim me shkollën e futbollit Anadrini , në kuadër të aktivitetave të shumta kushtuar Mujit të mërgimtarëve, kan realizua me sukses edhe turnirin në futboll të vogël ”Anadrini Cup. Aktivitetet u zhvilluan në fushën e futbollit në SHML 12 Maji në Ratkoc.



- Gjak muajit korrik është dhënë premiera e shfaqjes teatrale nga të rinjtë e Qendres Rinore SHT-KOSOSVA “QUO VADIS” nga regjisori Gjergj Mena. Kjo shfaqje është


realizuar në bashkëpunim të plotë me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport të komunës së Rahovecit në Qendren e kulturës "Mensur Zyberaj" në Rahovec



- Janë organizuar një sërë aktivitete e mbremje muzikore në bashkëpunim me lokalet të Palestra sportive "Mizahir Isma" me grupe e artist të njohur të estradës së Kosovës. Aktivitete jan realizuar në rrugën Xhevati Kasapi në Rahovec.




- Është intervenuar në funksionalizimin e fushës së futbollit në fshatin Dejnë pas dëmeve të shkaktuara gjatë vërvshimit në vitin e kaluar, ku tash më fusha është në funksion të klubit të Anadrinit dhe po zhvillon garat në ligën e tretë.



- Në Malësi të Vogël është përvuar fusha sportive bashkëkohore dhe me infrastrukturë të kompletuar.

Ky investim nga DKRS është pritur me një entuziazëm dhc gjëzim të madh në këtë mjeshtë mund të zhvillohen këto disciplina sportive për futboll, basketball dhe volejboll, që do t'u shërbejnë të rinjve, nxënësve dhe të gjithë qytetarëve të fshatit për sport e rekreacion.



- Kuvendi i Komunës së Rahovecit votoi për themelimin e Ansamblit të Këngëve dhe të Valleve të komunës së Rahovecit. Pas një pune me përkushtim të grupit punues për hartimin e statutit të Ansamblit, nën drejtimin e drejtorit të DKRS-së Afrim Dina, u bë e mundur të ky statut të harmonizohet dhe të vihet në rend të ditës për votim.



Në kuadër të shenimit të Ditës së Bibliotekës Komunale “Sulejman Krasniqi”, që shënon edhe ditëlindjen e tetëdhjetë e gjashtë të shkrimtarit, u publikuan edhe rezultatet e konkursit letrar për çmimin “**SULEJMAN KRASNIQI**”.

Juria profesionale në përbërje:

Leonora Bruçaj, poete dhe kandidate për doktorante në letërsi, ligjëruese në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan dhe në Universitetin “Fehmi Agani” në Gjakovë; poeti, romancieri e kritiku letrar Vilson Culaj dhe profesori i letërsisë Sokol Gashi.

Në adresë të këtij konkursi kishi arritur dyzet punime letrare, prozë dhe poezi, që sipas jurisë kishin nivel artistik të kënaqshëm. Pas analizës së kujdeshshme dhe debateve konstruktive të anëtarëve të jurisë, u nxorën këto përfundime:

- Me vendin e parë u vlerësua poczia, “Baladë për poetin” (kushtuar poetit Xhevdet Bajraj),

me shifrën “Ulpiana”

- Në vendin e dytë u vlerësua tregimi (proza) “Xhubleta” me shifrën (Erëmira 2023)

- Në vendin e tretë u rendit poezia – poemë “Ëndërrim” me shifrën (M. 81)

Konkursi letrar për çmimin “Sulejman Krasniqi” ka shtrirje kombëtare, çmim që është themeluar nga Komuna e Rahovecit për ndër të shkrimtarit Sulejman Krasniqi, i cili ka trajtuar romanin historik, por shquhet edhe për dramë, publicistikë, eseistikë e artikuj të shumtë në shtypin periodik në gjuhën shqipe.

Për tërheqjen e shpërblimeve fituesit duhet të lajmërohen në DKRS në Rahovec dhe me vete duhet të sjellin krijimet e tyre origjinale.

Me datë 28.12.2023 në sallën e Kuvendit Komunal, është organizuar ceremonia e zgjedhjes së laureatëve të sportit për vitin 2023 në komunën tonë.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm edhe yjet tanë që po na bëjnë krenarë me sukseset e tyre në arenën vendore e ndërkombëtare në futboll dhe në sporte të tjera.

Sportisti i vitit 2023 u zgjodh, Arbër Curri, Hendballist i KH Rahoveci, nga DKRS-ja janë ndarë edhe mërinjohje për sportiest të tjerë.

PËRFUNDIMI

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, përvç aktiviteteve të parapara për periudhën kohore janar- shtator 2023 është angazhuar në aktivitete dhe punë të ndryshme si:

- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve;
- Vizitë objekteve sportive;
- Takime me klubët dhe shoqata sportive;
- Vizitë objekteve kulturore;
- Takim me rini dhe shoqata e organizata rinore;
- Organizimi i aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive;
- Monitorimi i aktiviteteve të subvencionuara nga DKRS-ja;
- Takime të rregullta në kuadër të DKRS-së;
- Përgaditje të raporteve javore, mujore, tremujore, gjashtëmuajore,nëntëmuajore dhe vjetore.

Rahovec, 2023

Drejtor i DKRS-së

Afrim Dina

